

**C.nr.704/2012**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm Dvizioni Civil**, si gjykatë e shkallës së parë kontestimore, me gjyqtaren Mevlide Shabani, në lëndën kontestimore të paditëses R. V., nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ymer Huruglica, av. Nga Gjilani, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Siguria" në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Adnan Pacolli, jurist pranë të paditurës, baza e kontestit-kompensimi i dëmit, e pas mbajtjes së seancës kryesore më dt. 25.03.2014 mori këtë :

### **A K T G J Y K I M**

**I.PJESËRISHT APROVOHET** si e bazuar kërkespadija e paditëses, R. V., nga Gjilani dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve "Siguria" me seli në Prishtinë që paditëses në emër të kompensimit të dëmit të pësuar në aksidentin e datës 13.03.2011. t'ia paguaj shumat si vijon: Për dhimbje fizike, shumën prej 3.800 €, për frikë, shumën prej 2.500 €, për zvogëlim të aktivitetit jetësorë dhe vuajtje psikike e shpirtërore, shumën prej 2.800 €, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 1035 €, për kujdesin dhe ndihmën e huaj shumën prej 840 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 380 €, gjithsejtë 11.655.00 €, me kamatë vjetore prej 4.2 % ,duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me datë 25.03.2014, e deri në përmbushjen definitive të obligimeve të krijuara si në piken I . të dispozitivit të këtijë aktgjykimi.

**II. Për tepricen e kërkespadiës** me të cilën paditësja ka kërkuar që e paditura tia kompenzoi në emër të kompenzimit të dëmit të pësuar edhe shumën prej 5.210 €, **REFUZOHET** si e pa bazuar .

**III.DETYROHET** e paditura që paditëses të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore edhe ate 78 € për përpilimin e padisë, 540 € për përfaqsim në katër shqyrtime, 450 € për shpërblimin e ekspertëve, 55 €, për përpilim të aktgjykimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së këtijë aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësja R. V., nga Gjilani, nëpërmjet të autorizuarit të sajë, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës KS "Siguria", me seli në Prishtinë dhe në padi ka deklaruar se me datën 13.03.2011, në rrugën e Prishtinë-Gjilani, afër Liqenit të Badovcit, ka ndodhur aksident trafiku. Në këtë aksident paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore: ndrydhje të indeve të kokës, të kafazit të krahërorit dhe të shputës së këmbës së majtë dhe thyerje shumëpjesëshe të kockës navikulare të majtë, thyerje të kockës kuneiforme anësore dhe thyerje e

kockave metatarzale III dhe IV të shputës së këmbës së majtë dhe si rezultat i kësaj fatkeqësie paditësja, ka pësuar lëndime të rënda trupore, frikë te intensitetit të lartë, frikë të intensitetit të mesëm, dhimbje të intensitetit posaqërisht të lartë, dhe të mesëm, dhimbje shpirtërore. Të njëjtës si rezultat i këtij aksidenti ju ka zvogëluar aftësia e përgjithshme jetësore, ka qenë i nevojshëm ushqimi i përforcuar, ndihma dhe kujdesi i tjetrit, shërimi klimatik si dhe shpenzimet e tjera të shërimit. Automjeti shkaktar i aksidentit, në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë i siguruar te KS "Siguria", me polisë të sigurimit nr.0002716651.

I autorizuari i paditëses av.Ymer Huruglica, në seance e dat. 25.03.2014, ka precizuar kërkespadinë ashtu që ka kërkuar që e paditura KS "Siguria" që paditëses t'ia paguaj shumat si vijon: në emër të përjetimeve të dhimbjeve trupore të të gjitha llojeve ka kërkuar shumën prej 5.800 €, në emër të përjetimeve të friges primare dhe sekondare Shumen prej 3.500 €, në emër të zvoglimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor Shumen prej 2.800 €, në emër të shpenzimeve të mjekimit duke i përfshir edhe faturat Shumen prej 1.035 €, për kujdesin dhe ndihmen e huaj Shumen prej 1.180 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 920 €, dhe në emër të shpenzimeve të rehabilitimit shumën prej 1.630 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 4.2%, nga dita e shtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, duke shtuar se nuk është kontestuese fakti se paditësja ka psuar fatkeqsi komunikacioni me dat. 13. Mars, 2011, në rr. Prishtinë Gjilan, afer liqenit të badovcit, sipas pasagjeres në automjetin e udhtarëve Opel Astra, të cilin e kishte drejtuar Gzim Pajaziti, nga Gjilani, ku kishte pësuar lëndime trupore nga më të ndryshmet e që si rezultat i lëndimeve e njehta është ende duke u shëruar të cilën e vërtetojnë edhe konstatimet e ekspertit të psikiatrisë, ortopedisë dhe pulmologjisë, ku shihet se paditësja ka psuar dhimbje trupore të të gjitha llojeve të cilat pasaja janë duke e përcjellur edhe më tutje. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar .

përfaqsesi i tëpaditues KS "Siguria" Adnan Pacolli, nga Prishtina, ka mbetur në tërsi pranë përgjegjies në padi, duke mos e kundërshtuar kërkespadinë për nga baza por vetëm për nga lartësia e sajë.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje konkrete civilo-juridike, gjykata bëri shikimin dhe leximin e provave edhe atë : Raporti nga QKU Prishtinë, i dat.13.03.2011, raporti radiologjik i Qku-së, Prishtinë qendra diagnostike prova nr. 2 e dat.13.03.2011, raporti specialistik i psikiatrisë i qendres Denta Med, i dat. 16.03.2011, e lëshuar nga Aferdita Mulliqi, psikiatre, raporti specialistik i pulmologut në poliklinikën mjeksore Denta Med i dat 16.03.2011, raporti i qendres spitalore otorinolaringologut e dat.22.03.2011, raporti i qendres spitalore kirurgut torakal i dat 17.03.2011, raporti i mjekut ortoped traumatolog, i dat. 16.03.2011, raporti i mjekut kirurg torakal i dat.24.03.2011,raporti i mjekut ortoped i dt. 24.03.2011, raporti mbi trajtimin fizioterapik i dat. 13. 06.2011, e deri më 26.07.2011, raporti i mjekut ortoped

traumatolog i dat.03.08.2011, raporti mbi trajtimin fizioterapi i dat.16.08.2011, e deri më 27.08.2011, raporti i mjekut ortoped traumatolog, i dat.28.09.2011, raporti mbi trajtimin fizioterapik i dat.13.10.2011, e deri më 25.10.2011,raporti i mjekut ortoped traumatolog i dat.28.10.2011, raporti specialistik i pulmologut i dat.26.11.2011 dhe 03.12.2011, naliza laboratorike në ambulancën euromed në banjën Nëna Naile, në Kllokot, e dat. 03.12.2011, rezultati i radiologut i dat. 06.02.2012, raporti i QKUK-së, në Prishtinë klinika e kirurgjisë, i dat. 03.12.2012, shenjat mjekësore me nr. 32,33,34,35,36,37, ekspertiza mjekësore nga eksperti mjekoligjor dr. Flamur Blakaj, i dat. 15.08.2011, tri raportet e ortopedit të dat. 18/01/2013, 10.08.2013, 10.10.2013, raporti nga terapia i poliklinikës i dat. 29 Nëntor 2013, konstatimi radiologjik i dat. 04. Dhjetor 2012, dhe raporti nga konsullta i dat. 11 nëntor 2013

Pas vlerësimit të provave të administruara si dhe deklaratave të ndërgjygjësve dhe fakteve jo kontestuese në mes tyre ,në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së ,gjkata vërtetoi këtë gjendje faktike :Se me datën 13.03.2011, në rrugën Prishtinë-Gjilan, afer Liqenit të Badovcit, ka ndodhur aksident në Komunikacionin rrugor ,shkaktar i të cilit ishte vozitësi I. H., nga Prishtina, i cili e drejtonte automjetin e udhëtarëve me targa të regj.622 KS 378, duke mos i respektuar rregullat e trafikut public dhe duke mos e përshtatur shpejtësin kushteve në rrugë, humb kontrollin nga automjeti i tijë , del në shiritin e kundërt të rrugës, dhe në mënyr direkte e godet automjetin e udhëtarëve të markës Opel Astra, me targa të regj. 602 KS 862 e cila ishte duke qarkulluar nga drejtimi i kundërt dhe të cilën e drejtonte G. P., , nga Gjilani, ku me atë rastë pos demit material , lëndime të rënda trupore pëson paditësja si bashkudhëtare,këto fakte gjykata i ka vërtetuar me leximin e raportit të aksidentit me nr. Të rastit 2011 AR 0264, i cili nuk është kontestuar nga ana e të paditues.

Me leximin e ekspertizës mjekësore, të datës 16.11.2013, të përpiluar nga eksperti Ortoped traumatolog, Dr.Rrahman Hajdari, si dhe dëgjimin e ekspertit në seancë, gjykata ka vërtetuar faktin se si pasojë e aksidentit të dat. 13.03.2011, paditësja kishte pësuar edhe atë: lëndime të rënda trupore, dhembje fizike të intensitetit posaqërishtë të rëndë 1 orë deri në marrjen e ndihmës së parë,respektivishtë analgjetikëve në qendrën emergjente dhembje fizike të intensitetit të rëndë 3 ditë, pa aftësi të përkohëshme në punë në kohëzgjatje prej 3 muaj, ndihma dhe kujdesi i personit të tretë, nevoja për ushqim të përforcuar një muaj e gjysem, dhembje fizike të intensitetit të mesëm 30 ditë, dhembje fizike të intensitetit të ulët ka akoma dhe sotë janë prezentë në lëvizje të kufizuara të qafës gjatë aktiviteteve fizike, të nyjes talo krurale që përcillet edhe me ajtje të shputës. Zvogëlimim të përgjithshëm të aktivitetit jetësorë në tërësi prej 15 % edhe atë për shkak të lëvizjes së kufizuar të nyjes talo krurale me artroze të kockave tarzale.

Me leximin e ekspertizes mjekësore të dat.05.12.2013, e përpiluar nga eksperti i psikiatris dr. Qemajl Rexhepi, gjykata ka vërtetuar faktin se si pasojë e aksidentit, paditësja kishte pësuar frikë të intensitetit shumë të lartë, në formë të panikut 3-4 min., frikë të intensitetit të lartë një orë, frikë nga pasojat e lëndimit edhe më tej, brengosje për invaliditet po akoma, dhimbje shpirtrore mbi mesatare 18 muaj, brengosje për zvogëlim të aftësisë jetësore, pa mundësi për të vrapuar, pakësim i aftësive fizike, shëmtim mesatar në pamjen e këmbës së majtë, dhembje të përhershme të këmbës së intensitetit të lehtë.

Duke u nisur nga kjo gjendje faktike gjykata ka nxjerrë përfundim se kërkespadija e paditëses R. V., është pjesërisht e bazuar sepse nga provat e administruara u vërtetua se aksidenti i datës 13.03.2011, është shkaktuar me fajin e drejtuesit të automjetit VW – cadoy të tipit pick-up, me targa të regjistrimit 622 KS 378 ,i siguruar të e paditura në momentin e aksidentit ,dhe se si pasojë e këtij aksidenti të sipërpërmendur paditësja kishte pësuar dëm jomaterial edhe atë frikë, dhembje fizike,zvogëlim të aktivitetit të përhershëm jetësorë ,në shkallën 15 %.

Me dëgjimin e ekspertit pulmolog dr. Xhevdet Latifi, gjykata konstatoi se simptomat përcjellëse të paditësja do të jenë evidente edhe më tutje si dhembja, kollitja, diskomforti mund të jetë prezentë edhe për një kohë, pasi që veprimi mekanik i mjeteve të forta është rreflektu edhe në organin parenhimatoz-mushkri ku bzuar në strukturën anatomo-histologjike të mushkrive vulnerabilitetin e tyre , funksionin , sidomos të pjesëve bazale, dhe qrrregullimeve hemodinamike që ka pasur më vonë ka ardhur deri të një inflamacion akut e sidomos gjatë frymëmarrjes të përcjellura me edhe, temperaturë plogështi.

Me rastin e caktimit të shumave të cilat e paditura KS “Siguria” është e obliguar t’ia paguaj paditëses Ramize Veliu, në emër të shkaktimit të dëmit jomaterial, për dhembje fizike, për frikë,si dhe zvogëlim të aktivitetit të përhershëm jetësorë ,gjykata është nisur nga intensiteti dhe kohëzgjatja e dhembjeve fizike dhe frikës,si shkalla e zvogëlimit të aktivitetit të përhershëm jetësorë . Gjykata po ashtu me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjegjësishtë caktimit të shumave të cilat e paditura është e obliguar t’ia paguaj paditëses në emër të shkaktimit të dëmit jomaterial, për dhembje fizike, për frikë, aktivitetit të përhershëm jetësorë pati parasysh rëndësinë e së mirës së cënuar, qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, faktin që të mos favorizojë synimet që nuk përkojnë me natyrën dhe qëllimet e tyre shoqërore dhe duke u nisur nga këto arsye e ka detyruar të paditurën që paditëses t’ia pagua shumat si vijon: në emër të dhembjeve trupore fizike të të gjitha intensiteteve ,shumën prej 3800 euro, për frikë ,shumën prej 2500 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësorë dhe vuajtje psikike e shpirtërore ,shumën prej 2800 euro , për shpenzimet e mjekimit shumën prej 1035 euro, për kujdesin dhe ndihmën e huaj shumën prej 840 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 380 euro

Gjykata po ashtu me rastin e caktimit të shumave të cilat e paditura është e obliguar t’ia paguaj paditëses,në emër të dëmit jomaterial , në lartësinë si në

pikën I.1 të dispozitiv të këtij aktgjykimi pati parasysh faktin se caktimi i kompensimit për dëmin e pësuar të paditëses, në lartësinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ,është një satisfaksion për të dëmtuaren –paditësen e cila ka pësuar dëm jomaterial, e kjo me qëllim edhe të rivendosjes së barazpeshes [ekuilibrit] psikik dhe emocional të rrënuar të paditëses dhe kjo gjykatë ka vepruar në pajtim me dispozitat e neneve 200,190 të LMD-së ,përkatësishtë nenit 323 të LPK-së.

Gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar kërkespadin e paditëses për tepricën e kërkespadis për shumat më të larta se ato të gjykuara me arsyetim se një kërkes e tillë e paditëses nuk ka mbështetje në kriteret e përcaktuara lidhur me kompensimin e dëmit jo material dhe në vlersimin e lirë të gjykatës dhe për këtë ka vendosur si në pikën II të diapozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga arsyerat e cekuar më lartë e bazuar në nenin 143 dhe 146 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore është marrë sipas neni 452 të LPK dhe TA.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Me datë 25.03.2014**

Gjyqtarja  
 Mevlide Shabani

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:**kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmes të kësaj gjykate.